



This project is funded  
by the European Union

  
**Albania – Kosovo**  
IPA Cross Border Cooperation Programme

## Memo Informuese

**Project title:** Open ICT Education for Youth Employability

**Subject:** Memo Informuese Mbi Gjëndjen e Shkollave ku zbatohet projekti në Kurbin dhe Lezhë pas tërmetit të datës 26 Nëntor 2019

**Për:** Alessandra Frontoni, Programme Manager, Delegation of European Union to Albania

**Date:** 03.12.2019

### Notes:

Projekti Open ICT Education for Youth Employability me kontrate Granti Nr. 2017/394-533 zbatuar nga ODK dhe AIS me data zbatimi 15 Janar 2018 deri 15 Shkurt 2020 po punon me përfitues nxënës të shkollave të Bahskisë Kurbin dhe Bahskisë Lezhë.

Pas situatës Fatkeqësi Natyrore e shkaktuar nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019, në obejtket arsimore ku po punohet konstatohen problematika si vijon:

1. Shkolla e mesme Arif Halil Sula, njësia vendore Mamurras bashkia Kubin kontatohen dëme të rënda në godinën e shkollës. Shkolla është e mbyllur nuk lejohet të hynë në ambientet e brendshme persona civil jo të mobilizuar në situatën e emrgjencës. Priten rezultate të ekspertizës finale. Shkolla ka dëmtim të mureve, strukturave, dëmtime në orendi dhe pajisje. I dëmtuar rezultojnë edhe kabineti i informatikës. Pritet të merret vendim nga Zyra Arsimore Kurbin për zhvendosje të procesit mësimor në një godinë tjetër. Kjo shkollë ka zyrtarisht 489 nxënës. Foto dhe video ilustruese për këtë shkollë janë marrë nga stafi zbatues i projektit dhe ilustronjë dëme pjesa e brendshme dhe e jashtme e godinës. Kjo shkollë është 4.9 km larg Thumanës një nga zonat e banuara me dëme më të rënda dhe viktimat në njerëz.
2. Shkolla At Shtjefën Gjecovi Lac me xxx nxënës, ka dëmtime në godinë, kryesisht në kafazin e shkollës është dëmtuar pjesa suva mure. Dëmtime kanë muret e klasave dhe palestra e shkollës. Mësuesit nuk janë lejuar të hynë në brendësi të godinës. Pritet ekspertiza. Për këtë shkollë mendohet se mund të rikthehet në normalitet brenda disa ditëve.
3. Shkolla e mesme At Shjefen Kurti, paraqiten dëmtime të lehta në pjesën sipërfaqësore të mureve dhe në orendi (nga përplasjet). Shkolla ka strukturë të këngshme megjithëse është një shkollë e ndërtuar shumë vite më parë. Mendohet ti rikthehet brenda pak ditëve procesit normal të mësimi.
4. Shkolla e Mesme Milot, paraqiten dëmtime të lehta në pjesën sipërfaqësore të mureve dhe në orendi (nga përplasjet). Shkolla ka strukturë të këngshme megjithëse është një shkollë e ndërtuar shumë vite më parë. Mendohet ti rikthehet brenda pak ditëve procesit normal të mësimi.
5. Shkolla profesionale Kolin Gjoka, Lezhë paraqitet me dëmtime të lehta minimaliste. Kryesisht në klasat multifunksionale të ndërtuara mbi palestër. Këtu është i vendosur edhe laboratorit ku zhvillon aktivitetet projekti ynë. Pritet evidencë më e plotë e dëmeve.

Ky raportim nuk bazohet në ndonjë ekspertizë teknike, por është hartuar me ndihmën e Technical Leads dhe Oficerit Rajonal i Projektit duke u bazuar në kqyrje të jashtme dhe të brendshme të godinave.

Kjo memo do të pasohet nga një raportim më i detajuar në javën e dytë të dhjetorit.

Implemented by



ALBANIAN INSTITUTE  
of SCIENCE





This project is funded  
by the European Union

Më poshtë po ju bashkëlidhim dhe disa foto të dëmtimeve në ambientet e këtyre shkollave.

“Arif Halil Sula” High School



Implemented by



ALBANIAN INSTITUTE  
of SCIENCE





This project is funded  
by the European Union



Video:

- <https://1drv.ms/v/s!AolaQBW8UldogaxpgLTkHB2uky6eWA>
- <https://1drv.ms/v/s!AolaQBW8Uldogaxrb4M3Gen1djhKCg>
- <https://1drv.ms/v/s!AolaQBW8UldogaxqzKL2n78BZiREsg>

Implemented by






This project is funded  
by the European Union



**Albania – Kosovo**  
IPA Cross Border Cooperation Programme

“At Shtjefën Gjecovi” High School



Implemented by



ALBANIAN INSTITUTE  
of SCIENCE





This project is funded  
by the European Union



Milot High School:



Implemented by






This project is funded  
by the European Union



“At Shtjefën Kurti” High School:



“Kolin Gjoka” Vocational High School



Signature  
Besjana Hysa  
Project Officer Albanian Region